

# RELACION

## PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

### MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI MËNYRËN E ZBATIMIT TË AUDITIMIT TEKNIK PËR OBJEKTET TË CILAT KANË MBI 50 VJET QË JANË NDËRTUAR

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar” është hartuar me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, që do të konsistojë në kryerjen e ekspertizes së thelluar për të vlerësuar gjëndjen teknike aktuale dhe kapacitetin mbajtës të objekteve.

Objektivat që kërkohen të arrihen nëpërmjet këtij akti është që për objektet mbi 50 vjet nga ndërtimi i tyre të evidentohen dhe të ndërhyhet ku është e nevojshme, në se ato i plotësojnë kushtet bazë të: i) rezistencës dhe qëndrueshmërisë mekanike; ii) sigurisë nga zjarri; iii) higjienën, shëndetin dhe mjedisin; iv) sigurisë në përdorim; v) mbrojtjes nga zhurmat dhe vi) kursimit të energjisë dhe ruajtjes së ngrohtësisë.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi nuk është parashikuar në planin analitik të projekteve për vitin 2022.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar”

Futja në zbatim e rregulloreve mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar do të sjellë një kontroll më efikas, profesional dhe të përgjegjshëm në realizimin e ekspertizës së thelluar për një vlerësimin të gjëndjes teknike të objektit dhe kapacitetit të tij mbajtës sipas standardeve dhe kushteve teknike në fuqi. Përfitimet që rrjedhin nga përcaktimi i këtyre rregullave për objektet e ndërtuara para 50 viteve, do të jenë:

- Vlerësimi i gjëndjes teknike dhe kapacitetet e tij mbajtëse me plotësimin e kërkesave për:
  1. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;
  2. sigurinë nga zjarri;
  3. higjienën, shëndetin dhe mjedisin;
  4. sigurinë në përdorim;
  5. mbrojtjen nga zhurmat;
  6. kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.
- Rritja e sigurisë në përdorim;
- Uljen e kostove të tepërta për mirëmbajtjen dhe admiistrimin;
- Rritja e jetëgjatësisë së veprës.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi bazohet në përcaktimet e Nenit 4/1 të ligjit të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: *"Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave"*.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon të përafrojë acquis communautaire.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar"



Projektvendimi "Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar" përbëhet nga dy Krerë dhe gjithsej 18 pika:

Në pikën 1 përcaktohet që të gjitha objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar i nënshtrohen procesit të auditimit teknik.

Në pikën 2 parashikohet që nëpërmjet Auditimi teknik konsistonë në ekspertizën e thelluar për vlerësimin e gjëndjes teknike të objektit dhe kapacitetit të tij mbajtës për të përcaktuar nëse këto objekte plotësojnë kushtet e rezistencës dhe qëndrueshmërisë mekanike.

Në pikën 3 është përcaktuar që auditimi teknik kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore në përputhje me kushtet teknike dhe standardet e projektimit në fuqi.

Në pikën 4 është përcaktuar që objektet që i nënshtrohet auditimit teknik identifikohen nga organet e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në pikën 5 është përcaktuar që objektet e identifikuar përzgjedhen, për t'iu nënshtuar auditimit teknik, sipas një rradhe të përcaktuar nga objekti me rrezikshmëri më të lartë deri tek ai me rrezikshmëri më të ulët, mbështetur në studimin paraprak në bazë të kriterëve për:

- a) shkallën e rrezikshmërisë që sjell objekti në përdorim dhe në ambjentin përreth;
- b) kohën e ndërtimit të objektit;
- c) kohën e shfrytëzimit të objektit;
- d) në se objekti është në funksion apo jo;
- e) ndryshimi i destinacionit në vite që mundet të jetë shoqëruar me ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit e cila sjell rrezikshmeri në qëndryeshmërinë e tij;
- f) mirëmbajtja dhe rikonstruksioni në vite,
- g) rrezikshmërinë që mundet të jetë shkaktuar nga formacioni gjeologjik dhe sizmik i terrenit ku është ndërtuar objekti.



Në pikën 6 është përcaktuar që akti i ekspertimit të thelluar identifikon dëmet që mundet t'i jenë shkaktuar objektit në vite në tërësi apo në pjesë të tij, si dhe në plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi duke iu nënshtruar llogaritjeve sipas kushteve dhe standardeve në fuqi.

Në pikën 7 është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore përzgjedhin subjektin auditees që do të bëjnë auditimin teknik të objekteve

Në pikën 8 është përcaktuar që subjektet audituese që do të përzgjidhen duhet të jenë pajisur me licencës në fushën e projektimit për llojin e objektit që do të auditohet.

Në pikën 9 është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore sigurojnë materialin e nevojshëm për kryerjen e procesit të auditimit në bashkëpunim me Arkivin Qëndror Teknik të Ndërtimit.

Në pikën 10 është përcaktuar që Auditimi teknik i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit kryerjen e oponencës jep mendimin e tij, i cili mbizotëron mbi aktauditimin teknik dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.

Në pikën 11 është përcaktuar që pas kryerjes së oponencës dhe analizimit ekonomik financiar mbi mundësinë më optimale për të riparuar apo prishur dhe rindërtuar objektin Instituti i Ndërtimit informon ministrinë që ka në përgjegjësinë e saj fushën e ndërtimit apo bashkinë nën juridiksionin e të cilit ndodhet territori ku ngrihet objekti, mbi konkluzionin e arritur.

Në pikën 12 është parashikuar që autoritetet përgjegjëse për objektet publike shtetërore që kanë në përgjegjësi administrimi dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për objektet publike në pronësi dhe për objektet private nën juridiksionin territorial të tyre, në bazë të mendimit të Instituti i Ndërtimit, marrin vendimin për riparimin apo prishjen e objektit.

Në pikën 13 është përcaktuar që në rast se rezulton se objekti nuk plotëson kushtet teknike të projektimit në fuqi, por ndërhyrja në strukturat mbajtëse të tij

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar"



e kthen atë në kushte optimale përdorimi, në këtë rast objekti i nënshtrohen riparimit.

Në pikën 14 është përcaktuar se vendimi për prishje të objektit mund të merret në rast se vlera për riparim është e barazvlefshme ose më e madhe se vlera për ndërtimin e tij.

Në pikën 15 është përcaktuar që për kryerjen e prishjes, riparimeve, ose ndërtimit të objekteve, nga nisja e këtyre proceseve deri në procesin përfundimtar të certifikimit të punimeve, institucionet përgjegjëse zbatojnë procedurën dhe rregullat sipas legjislacionit në fuqi.

Në pikën 16 përcaktohet që Auditimi teknik për objekte publike ose private, mbështetur në akt ekspertizën e thelluar që kryhet sipas hapave të më poshtme:

- a) njohja me e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për objektin, si:
  - i. projektin arkitektonik;
  - ii. projektin konstruktiv;
  - iii. lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse;
  - iv. studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
  - v. studimin sizmik;
  - vi. procesverbalet e punimeve të maskuara;
  - vii. raportin e llogaritjes së strukturës.;
- b) mbledhjen informacionit mbi kushtet atmosferike, sizmike dhe gjeologjike për zonën ku ndodhet objekti që i është nënshtuar auditimit;
- c) Azhornimi gjeometrik dhe teknik;
- d) marrja dhe kryerja e provave laboratorike në bashkëpunim me laborator të akredituar, detyrimisht për elementët bazë të qëndrueshmërisë si betoni, hekuri, tulla, dhe të gjithë elementëve mbajtës, si dhe çdo provë tjetër që është e nevojshme për të arritur në gjykimin përfundimtar;
- e) Evidentimin e ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit gjatë kohës së shfrytëzimit;
- f) Përditësimin gjeometrik të strukturës;
- g) Mbledhjen e dokumentacionit të zbatimit;
- h) Katalogimin e dëmtimeve në objekt;

- i) Gjykimin inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit;
- j) llogaritja e qëndrueshmërisë;
- k) hartimi i projektit për ndërhyrje rehabilituese, nëse nga llogaritjet del i nevojshëm përforcimi i strukturës mbajtëse;
- l) hartimi i preventivit të punimeve për ndërhyrjet që duhen bërë në objekt;
- gj) hartimi i raportit përfundimtar mbi gjëndjen e objektit, sugjerimin për ndërhyrje, në rast se vlerësohet e nevojshme, për ta kthyer objektin në gjëndje optimale në plotësim të kushteve të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- h) Për objektet pa projekt teknik të realizohet dokumentimi gjeometrik dhe teknik i strukturës së objektit, që përfshin realizimin e:
  - i) detajimit gjeometrik, planeve të strukturave dhe të dimensionimeve gjeometrike të elementeve strukturale;
  - ii) rojektimit simulues;
  - iii) studimit gjeologjik dhe projektit simulues të themeleve.

Në pikën 17 përcaktohet që dokumentacioni shoqërues i auditimit teknik duhet të përmbajë:

- a) Studimin e strukturave sipas përcaktimeve të standarteve dhe normave në fuqi:
  - i. Studimi gjeometrik;
  - ii. Studimi i materialit;
  - iii. Studimi i detajimeve.
- b) studimin e strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të;
- c) realizimin e studimit gjeologjik;
- d) realizimin e studimit sizmik;
- e) evidentimin dhe katalogimin e dëmtimeve në rastet kur ka;
- f) analizën lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës;



- g) analizën jolineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, sipas njërës nga metodat e përshtatshme për tipin e strukturës që po analizohet;
- h) konkluzionin për performancën e godinës, sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin;
- i) rekomandimet për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me to.
- j) Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/ përshtatëse hartohet në bazë të kushteve teknike të projektimit në fuqi dhe të standardeve evropiane të transpozuar. Hartimi i projektit mbështetet në rekomandimet e analizës dhe përfshin të gjitha detajet e nevojshme për ndërhyrje si dhe metodologjinë e aplikimit.
- k) Projektin e prishjes në raste se është arritur në konkluzionin për prishje të objektit.
- l) Informacioni i mbledhur mbi kushtet atmosferike, sizmike dhe gjeologjike për zonën ku ndodhet objekti;
- m) Provat laboratorike të kryera, nga laborator të akredituar, për elementët bazë të qëndrueshmërisë si betoni, hekuri, tulla, dhe të gjithë elementëve mbajtës, si dhe çdo provë tjetër që ka qënë e nevojshme për të arritur në gjykimin përfundimtar;
- n) Preventivi përfundimtar i ndërhyrjeve, si në rastin e rikonstruksionit dhe atyre të prishjes.
- dh) Në mungesë të projekteve, do të realizohet projektimi simulues bazuar në kushtet teknike në fuqi.

Në pikën 18 është përcaktuar që për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Autoritetet përgjegjëse që kanë në përgjegjësi administrimi objekte publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Instituti i Ndërtimit dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar"

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Autoritetet përgjegjëse që kanë në përgjegjësi administrimi objekte publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Instituti i Ndërtimit dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit.

### **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky projektvendim është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Përsa u përket shpenzimeve buxhetore në projektakt nuk parashikohet që të ketë të tilla.

**ZËVENDËKRYEMINISTËR  
DHE  
MINISTËR**

**Belinda Balluku**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave mbi mënyrën e zbatimit të auditimit teknik për objektet të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar"